

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
PROINFINIT CONSULTING SH.P.K.**

Sot, më 25 shkurt 2022 në Tiranë, **PROINFINIT SH.P.K** si më poshtë "**Ortaku**" përpilon këtë Akt Themelimi për themelimin e Shoqërisë **PROINFINIT CONSULTING Sh.p.k.** si vijon:

Ortaku Themelues:

PROINFINIT SH.P.K, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numër unik identifikimi (NUIS) L92204018G, në adresën "Njësia Bashkiake Nr.5, Rr. Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Godina 8/2 Kati 2, Zona Kadastrale 8260 Tiranë, Shqipëri.

I. THEMELIMI

PROINFINIT SH.P.K deklarojnë themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "**PROINFINIT CONSULTING**" Sh.p.k., person juridik shqiptar, (referuar me poshtë si "**Shoqëria**"), bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me ndryshime ("**Ligji Tregtar**").

II. SELIA

Selia e Shoqërisë është në adresën: "Njësia Bashkiake Nr. 5, Kompleksi Kika 2, Kati 1, 1c/8, Zona Kadastrale 8260 Tiranë, Shqipëri".

Shoqëria rezervon të drejtën të transferojë selinë e saj në një adresë dhe/ apo në një qytet tjetër të Shqipërisë.

III. KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Kohëzgjatja e Shoqërisë është me afat të papërcaktuar.

IV. OBJEKTI

Objekti kryesor i Shoqërisë është si vijon:

Ofrimi i shërbimeve të konsulencës në fushën e manaxhimit të biznesit, shërbime të auditimit, konsulencës financiare, taksave, shit-blerjen ose bashkimin e kompanive, plane fizibiliteti, plane biznesi, studime dhe analiza si dhe të gjitha shërbimet në fushën e konsulencës në të gjithë sektorët dhe industrinë. Mbatje të kontabilitetit, evidencave financiare ose operacionale, kryerje të proceseve të biznesit, shërbime të përkthimit, redaktimit dhe prezantimit të punimeve, materialeve, raporteve dhe studimeve të ndryshme. Hartim të manualeve, procedurave, udhëzimeve. Ngritje të kapaciteteve dhe konsulencë në drejtimin manaxherial dhe operativ. Shërbime të trajnimit dhe zhvillimit. Ndërmjetësim për tregun e punës, rekrutime, trainime dhe programe kualifikimi të ndryshme. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpërmendur, Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, dhenie/marrje me qera, të vendosë pengje dhe barrë hipotekore; aktivitete këto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara më sipër; të blejë në mënyrë direkte apo indirekte, kuota të shoqërive të tjera që kanë një objekt të përafërt me atë të Shoqërisë, në Shqipëri ose jashtë shtetit; të kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm ose i domosdoshëm për të arritur qëllimin e aktivitetit të saj.



Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Shqipëri. Ajo zbaton standartet më të larta të etikës profesionale.

V. STATUTI

Ortaku deklaron për pajisjen e Shoqërisë me Statut, i cili të nënshkruhet nga Ortaku.

VI. KAPITALI

Kapitali Themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë e zakonshme vlera nominale e së cilës është 500,000 (pesëqind mijë) Lekë i cili zotërohet 100% nga ortaku themelues PROINFINIT SH.P.K

VII. ADMINISTRATORI

Administratori i Shoqërisë do të jetë **Znj. Desara Liko**, lindur në Tiranë më 12.08.1982, me numër personal identifikimi I25812051J dhe emerohet për një afat 5 (pesë) vjeçar dhe mund të rimerohet.

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje origjinale në shqip dhe konsiderohet si mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë. Ky Akt Themelimi është hartuar sipas Ligjit Tregtar.

ORTAKU THEMELUES

PROINFINIT SH.P.K


Fullonza Gjozi
Administrator
